



Pranimi / Dorezimi Puniljenia / Pradato Received / Delivery	05-05-2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM&HUK	2635/2022		115



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.321/2022

Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.64/20 të datës 21.03.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.707/2019 të datës 13.11.2019 të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësuar Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.05.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.707/2019 e datës 13.11.2019 e parashtruar nga ankuesja
- II. **Mbetet në fuqi** Njoftimi për kandidatin e suksesshëm i datës 30.08.2019 për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Rrezikut.
- III. **Obligohet** Kryeshefi Ekzekutiv dhe Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të lëshoj Akt Emërimin për ankuesen në pajtim me legjislacionin në fuqi për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Rrezikut.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale në bazë të autorizimit të Departamentit të Administrimit të Shërimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike me datë 06.08.2019 ka shpallur konkursin e brendshëm për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Rrezikut. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila është ftuar të marrë pjesë në fazat e procedurës së rekrutimit (testin me shkrim dhe me gojë).

Pas përfundimit të procedurës, më datë 30.08.2019 është publikuar njoftimi për kandidatin e suksesshëm, ku ankuesja ka rezultuar si konkandidate e suksesshme me 98.5% të pikëve, mirëpo Divizioni i Burimeve Njerëzore ka bërë anulimin e konkursin pa ndonjë arsye.

Ankuesja kundër këtij njoftimi më datë 12.09.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale më datë 14.10.2019 ka nxjerr Vendim me Nr.Prot:4228/2 me të cilin ka vendosur që konsiderohet e bazuar ankesa e ankueses.

Ankuesja kundër moszbatimit të Vendimit me Nr.Prot:4228/2 të datës 14.10.2019 të Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale, më datë 13.11.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5339/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli, në mungesë të kuorumit për vendosje, më datë 23.12.2019 ka njoftuar ankuesen lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe ka udhëzuar të njëjtin që t'i ndjek procedurat e mëtejme në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ. Ankuesi, në mungesë të kuorumit për vendosje ka ndjekur procedurat gjyqësore dhe si rrjedhojë ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 21.03.2022 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.60/20 me të cilin ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën e datës 13.11.2019 të parashtruar nga ankuesja.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5339/2019 të datës 13.11.2019 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin e Brendshëm i datës 06.08.2019 për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Rrezikut; Njoftimin për testin me shkrim i datës 19.08.2019; Njoftimin për intervistë me gojë i datës 21.08.2019; Njoftimin për kandidatin e suksesshëm i datës 30.08.2019;

Form.MAP-SHCK-10 për renditjen përfundimtare të kandidatëve; Njoftimin për anulimin e konkurseve; Emailin e datës 06.09.2019 nga ankuesja; Emailin e datës 11.09.2019 për ankuesen; Ankesën e datës 12.09.2019 nga ankuesja në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin e datës 14.10.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Emailin e datës 28.10.2019 të ankueses; Emailin e datës 30.10.2019 për ankuesen; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 18.11.2019; Përgjigjen në ankesë e datës 19.12.2019; Autorizim nga DASHC/MAP; Vendimin e datës 15.08.2019 për emërimin e Komisionit Përzgjedhës; Form.MAP-SHCK-04 për regjistrin e aplikacioneve të pranuar; Form.MAP-SHCK-06 për njoftimin e kandidatëve për testimin nga përzgjedhja e ngushtë; Form.MAP-SHCK-07 për përcaktimin e kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Form.MAP-SHCK-09 për përmbledhjen e vlerësimeve individuale; Raportit final i rekomandimi nga komisioni rekrutues datë 28.08.2019; Form.MAP-SHCK-05 për përcaktimin e kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë; Form.MAP-SHCK-08 për vlerësimin individual të kandidatëve për vendin e punës për të cilin kërkohet njohja e ndonjë gjuhë të huaj; Testin me shkrim; Propozimin për anulimin e konkurseve i datës 02.09.2019; Vendimin e datës 01.06.2017 për transferim në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Implementimin e Masave të Menaxhimit të Rrezikut; Vendimin e datës 04.05.2016 për transferim të përkohshëm në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Implementimin e Masave të Menaxhimit të Rrezikut; Ndryshimin dhe Plotësimin i Aktit të Emërimit i datës 06.05.2016; Njoftimin e datës 23.12.2019 për ankuesen dhe Aktgjykimin A.nr.64/20 të datës 21.03.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankueses, është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses e cila ka kërkuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të obligojë institucionin që të më lëshoj akt emërimit për pozitë që kam fituar.

Bazuar në shkresat e lëndës, anulimi konkursin nga Divizioni i Burimeve Njerëzore i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale është pa ndonjë bazë juridike, mirëpo në bazë të komunikimeve që janë pjesë e lëndës, ky anulim është bërë për shkak të mungesës së buxhetit.

Rregullorja Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, gjegjësisht neni 3 paragrafi 1, përcakton se: *"Procesi i rekrutimit iniciohet dhe realizohet nga institucioni kompetent për të siguruar mbajtjen e një niveli dhe të bazë të qëndrueshme dhe profesionale të nëpunësve civilë"*, ndërsa paragrafi 2 i këtij neni, përcakton se: *"Rekrutimi në Shërbimin Civil bëhet në përputhje me nevojat për personel që kërkohen në planet e burimeve njerëzore në përputhje me nenin 18 paragrafi 1 të Ligjit për Shërbimin Civil dhe pas konfirmimit të disponueshmërisë së mjeteve buxhetore për pozitat e krijuara apo të lira"*.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se nëse nuk do të kishte buxhet atëherë as kërkesa për iniciimin e procedurës së rekrutimit nuk do të mund të bëhej pranë Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike, si rrjedhojë, anulimi i konkursit bëhet vetëm në rastet kur kjo është paraparë Rregullorja Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe duhet të përmbaj arsyë lidhur me shkaqet e anulimit të tij, në këtë rast njoftimi për anulimin e konkursit nuk përmban asnjë arsyezim pse është anuluar ky konkurs.

Gjatë shqyrtimit të procedurës së rekrutimit, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se procedura e rekrutimit është zhvilluar brenda afateve ligjore të përcaktuar me Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, po ashtu e njëjta procedurë është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafin 9, nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: *"Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës"* dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, dhe nuk ka pasur bazë juridike për anulim të këtij procesi.

Bazuar në të lartcekurat, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Kryeshefi Ekzekutiv dhe Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale është i obliguar që t'i ndërmarr veprimet në pajtim me dispozitën e lartcekur, të bëjë lëshimin e Akt Emërimit për kandidatin e suksesshëm respektivisht për ankuesen për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Rrezikut", kështu që pretendimet e ankueses janë të bazuara.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *"Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës"*, dhe me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të po këtij ligji është përcaktuar se: *"Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit"*.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh

nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.321/2022

Avdyl BEKTESHI

  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë e Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

